



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Opština Drenas –Municipality of Drenas  
Zyra e Kryetarit



P R O C E S V E R B A L

I

TUBIMIT TË PARË ME PUBLIKUN

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	05/07/2024	j. Org.	Numëri
01	060/04/31802	Shtojca	Vlera

Datë: 28.06.2024

Ora: 14:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Tubimi me publikun në lidhje me aktivitetet e komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, u mbajt me datë 28 qershor 2024. Këtë tubim e hapi nën kryetari i komunës së Drenasit, z. Arben Shala, dhe të pranishëm ishin:

Ramiz Lladroveci	Kryetar i Komunës
Arben Shala	Nën kryetar i Komunës
Laureta Thaqi	Drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme
Petrit Gashi	Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
Agnesë Kastrati-Bucolli	Drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik
Muhamed Gjoka	Drejtor për Drejtorinë për Arsim
Lumnije Krapi	Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Anita Avdullahu	Drejtoreshë e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Albulena Saliuku	Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
Enkela Dema	Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
Vlora Gjinovci	Udhëheqëse e sektorit, Drejtoria për Infrastrukturë Lokale



Në këtë tubim me publikun, përfaqësuesit e komunës informuan pjesëmarrësit rrëth projekteve dhe aktiviteteve të realizuara, si dhe atyre që janë në planifikim për t'u realizuar gjatë këtij viti.

**Kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci**, falënderoi qytetarët për bashkëpunim, të cilët e kanë prioritet të mirën e përgjithshme dhe të komunitetit që kujdesen për mbarëvajtjen e punës tonë, duke na njoftuar me nevojat, për cilësinë e punëve të kryera, për vërejtjet dhe ankesat.

Në veçanti falënderoi administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për realizimin e synimeve të përbashkëta dhe mirëqenien e qytetarëve. Kërkoi po ashtu të jenë si deri më tanë, bashkëpunues por edhe mirëkuptues, të jenë ankues por edhe mirënjobës që së bashku po e bëjmë më të mirën për qytetarët tanë.

Falënderoi po ashtu drejtorët e Kabinetit që me përkushtim po e zbatojnë punën e planifikuar, buxhetin dhe afatet e investimeve te projektet kapitale.

Ndër tjerash, të pranishmëve ju drejtua me këtë fjalim:

Të nderuar qytetarë të Drenasit

Të nderuar administratorë të vendbanimeve,

I nderuari nënkyetar Shala,

Asamblistë e anëtarë të Kabinetit,

Zonja e zotërinj,

Ju faleminderit për pjesëmarrjen në këtë tubim me publikun.

Komuna e Drenasit me të gjitha mundësitë jemi duke u angazhuar për projektet e planifikuara sipas buxhetit të miratuar në Kuvendin Komunal, por edhe kërkesave që mund të dalin në ndërkokë.

Falënderoj të gjithë qytetarët, për bashkëpunim, të cilët e kanë prioritet të mirën e përgjithshme dhe të komunitetit, që kujdesen për mbarëvajtjen e punës tonë, duke na njoftuar me nevojat, për cilësinë e punëve të kryera, për vërejtjet dhe ankesat.

Sot, në veçanti dua të falënderoj administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën e tyre, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për realizimin e synimeve të përbashkëta për mirëqenien e qytetarëve, të vendbanimit, lagjeve apo familjeve të caktuara.

Të nderuar të pranishëm,

Sipas informacioneve që disponojmë, raporti i Auditorit të përgjithshëm për vitin 2023, komunën e Drenasit e ka nxjerr në mesin e komunave me Raportin e Auditimit më të mirë në nivel nacional.



Sipas matjeve për garën e Grantit të performancës, po ashtu, sipas informatave që disponojmë, edhe viti 2023, vendi i parë do të jetë i rezervuar për komunën e Drenasit.

Jemi kampion të performancës sepse, jeni ju, qytetarët e komunës së Drenasit qytetarë shembullor.

Të nderuar të pranishëm,

Gjatë kësaj periudhe sa po raportojmë, komuna jonë është komunë vendpunishte.

E di se dikujt po ia vret sytë puna jonë, por, ne nuk do të ndalemi.

E di se kur na mungonin parkingjet, merrnim kritika se s'kemi parkingje, tash ka ankesa se kemi tepër parkingje.

Besoj e dini se kush mund të na kritikojë për këtë.

Janë duke u realizuar shumë projekte infrastrukturore.

Janë asfaltuar e do të asfaltohen rrugica gjithandej komunës, pa dallim, gjithmonë sipas planit të parashikuar.

Po ashtu po vazhdon përpjekja përfshirë aftësimin e rezervuarit dhe gypave për ujë. Sot i takova qytetarët e Vasilevës, ua shpjegova të vërtetën për vonesat, ku ne si komunë, nuk e kemi asnjë përgjegjësi. Kemi investuar për Ujësjellës, kemi zhvilluar projekte të ujësjellësit, por, ne nuk mund bëjmë më shumë.

Rrjetit të kanalizimit në shumicën e vendbanimeve e kemi të realizuar, ndërsa mund të themi se kemi rehabilituar mbi 15.000 metra për kohën e raportimit.

Çështje me prioritet e kemi impiantin për pastrimin e ujit, kemi kërkuar ndihmën e Qeverisë dhe Zyrës së Bashkimit Evropian.

Cili është efekti të heqim ujërat e zeza nga komuna jonë dhe ia lëshojmë atë ujë komunës së Fushë Kosovës.

Sa i takon ndriçimit publik, nga raporti i fundit, i kemi ndërtuar më shumë se 38.197 metra gjatësi.

Kemi zgjeruar rreth rrotullimin, kemi rehabilituar dhe rikonstruktuar rrugët në tërë komunën e Drenasit. Është rregulluar parkingu te Blloku i kuq, Ruga Adem Mula, te Tregu i qytetit, parkingu te Stacioni i autobusëve.

Ruga Llapushnik Berishë, Parku në Kamenicë, te Pishat e Gllobarit.

Sheshi “Fehmi Lladrovci” po finalizohet. JU siguroj se do të kemi Sheshin më të bukur në Kosovë dhe më gjérë.



Nuk do të hyj në detajet e rrugëve, rrugicave dhe punët tjera, sepse, është regjistër i gjatë.

E di, kemi hala edhe shumë punë për të bërë.

Ne nuk do të ndalemi.

Në arsim, shëndetësi, inspektoratet dhe drejtoritë tjera, janë me raporte të gjata për punën dhe aktivitetet e kryera.

Mos kërkoni përgjegjësi nga unë për QKMF, sepse, procedura nuk është në dorën tonë, as përshpejtimi, as ngadalësimi, është çështje e Ministrisë së Shëndetësisë.

Renovimi i objekteve shkolllore, ngrohja, energjia e rinoqvueshme, dhe tërë logjistika e arsimit të përparuar, tashmë është përditshmëri.

Përkrahja për fermerë përmes subvencionimit me pajisje të nevojshme po vazhdon, do të dëshironim të kemi më shumë mundësi, sepse fermerët tanë e meritojnë, por, këto janë mundësitë sipas ndarjeve buxhetore.

Kemi bërë mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror dhe veror, mirëmbajtja e kanalizimeve, mirëmbajtjen e rrugëve të rendit të katërt, mirëmbajtja e parqeve, shesheve e gjelbërimi i hapësirave publike, mirëmbajtja e ndriçimit publik, kujdesi dhe zgjerimi për menaxhimin e mbeturinave, pastrimi i deponive ilegale dhe shumë e shumë projekte të tjera publike.

Kemi filluar edhe me aksionin “Bashkë për pastërtinë në Komunën e Drenasit – zemrën e Kosovës”.

I falënderoj të gjithë ata që u kyçen dhe vazhdojnë të mbajnë ambientin e pastër, drejtorët e shkollave, arsimtarët, nxënësit e prindërit e nxënësve, donatorët, Policinë e Kosovës, KFOR-in dhe dashamirët e pastërtisë në komunën tonë.

Në sektorin e kulturës, rinisë e sportit jemi duke vazhduar me realizimin e projekteve. Stadiumi i qytetit “Rexhep Rexhepi”, dal ngadalë po merr formën e finalizimit duke i plotësuar standarde të FIFA dhe UEFA.

Palestra “Hysni Jetullahi” është në proces të rinvimit.

Stadiumi nacional, është brenda Strategjisë afatmesme të Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sportit. Janë të planifikuara 30 milion euro për këtë fazë afatmesme.

Qendra e Biznesit Drenasi 2, është duke u finalizuar.

Ruga Feronikel - Kroni Mbretit është duke u finalizuar, aktualisht e asfaltuar por jo e gjithë traseja. Edhe këtu, ne nuk kemi përgjegjësi për përshpejtëm të punimeve.

Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave ia kemi dhënë pa pagesë hapësirën afér shkollës “Rasim Kiçina”.



Çerdhja në qendër, është para finalizimit dhe presim në shtator të jetë gati për më të dashurit tanë, fëmijët.

Përkrahja për ekonominë, për të rinjtë, për kulturën dhe të gjitha veprimtaritë e pushtetit lokal, do të përkrahen me aq sa kemi mundësi.

Kërkoj të jeni si deri tash, bashkëpunues por edhe mirëkuptues, të jeni ankues por edhe mirënjoħes që së bashku po e bëjmë më të mirën për qytetarët tanë.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për këtë gjashtëmuajor, pjesëmarrësit parashtruan kérkesa, ofruan sugjerime dhe dhanë komentet e tyre.

**Kérkesat e parashtruara, sugjerimet dhe komentet e dhëna kryesisht u bënë nga:**

<b>Habib Mulaj</b>	Afarist, Drenas
<b>Ismail Hoti</b>	Fshati Térdec
<b>Ilir Mulaj</b>	Afarist, Drenas
<b>Izet Bytyqi</b>	Përfaqësues i fshatit Fushticë e Epërme
<b>Agron Gashani</b>	Përfaqësues i lagjes Gashani, fshati Térstenik
<b>Adem Qorri</b>	Drenasi 2
<b>Rinor Morina</b>	Fshati Gllobar
<b>Zekë Kluna</b>	Administrator i fshatrave Poklek i Vjetë dhe Vasilevë
<b>Jahir Beqiri</b>	Administrator i Drenasit 2
<b>Habib Gashi</b>	Përfaqësues i fshatit Nekoc
<b>Xhafer Dobërdolani</b>	Administrator i fshatit Korroticë e Epërme
<b>Xhevdet Shishani</b>	Administrator i fshatrave Dobroshec, Çikëtove e Vjetër dhe Godanc
<b>Arben Bazaj</b>	Përfaqësues i lagjes Bazaj, Térstenik 2
<b>Kadri Ajazi</b>	Administrator i fshatrave Sankoc dhe Fushticë e Ulët



Kërkesat e parashtruara nga të lartpërmendurit ishin kryesisht të natyrës së ngjashme, duke përfshirë: ndriçimin publik, infrastrukturën rrugore (mirëmbajtja, shtrimi dhe asfaltimi i rrugicave dhe trotuareve), ujësjellës dhe kanalizim. Sugjerimi kishte të bënte me pezullim të punimeve me afat të caktuar, dhe komentet kryesisht ishin të llojit të përgëzimit për punën e bërë deri me tanë.

#### **Kërkesat, sugjerimet dhe komentet e paraqitura në formë tabelore:**

Lloji:	Total:	Statusi:
<b>Kërkesa</b>	<b>12</b>	<b>Pranohen</b>
Përbajtja	<b>Përgjigje</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndriçimi publik,</li> <li>• Infrastrukturën rrugore [mirëmbajtja, shtrimi dhe asfaltimi i rrugicave dhe trotuareve, vendosja e shenjave kufizuese],</li> <li>• Ujësjellës [shtrimi i gypave, lidhjet], dhe</li> <li>• Kanalizim [Pusetat, kapakët e pusetave]</li> </ul>	<p>Të gjitha kërkesave të parashtruara, kryetari i komunës së Drenasit, z. Ramiz Lladrovci në bashkëkoordinim me drejtoritë përkatëse u dha përgjigje, duke theksuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Ndriçimi publik</b> - është pothuajse i përfunduar, tashmë shumica e vendbanimeve kanë ndriçim.</li> <li>• <b>Infrastruktura rrugore</b> - është në drejtimin e duhur; punohet me intensitet të lartë dhe të gjitha projektet po zhvillohen sipas planit të urbanizimit të paraparë. Do të shqyrtohet vendosja e shenjave kufizuese [aty ku është e nevojshme vendosja e tyre].</li> <li>• <b>Ujësjellësi</b> - shumica e punimeve janë përfunduar nga komuna; janë instaluar gypa të rinj dhe pompa. Ka disa sfida në disa fshatra, por pritet që ato të zgjidhen së shpejti.</li> <li>• <b>Kanalizimi</b> - është në fazën përfundimtare. Ka disa pengesa, por ato janë nën kontroll dhe pritet të menaxhohen. Sa i përket puestave dhe kapakëve të tyre, sigurisht që drejtoria përkatëse do ta rregulloj këtë çështje.</li> </ul>	



Lloji:	Total:	Statusi:
Sugjerime	2	Pjesërisht pranohen
Sugjerimet	Përgjigje	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Pezullimi i punimeve deri në shtator</li> </ul> <p>Duke marrë parasysh sezonin kur mërgimtarët vijnë në Kosovë dhe pritet që objektet afariste të kenë më shumë aktivitet, sugjerojmë që punimet në sheshin që është në ndërtim të pezullohen deri në shtator.</p>	<b>Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës:</b> Sigurisht që do ta kemi parasysh këtë sugjerim. Besoj se sheshi pothuajse do të përfundojë deri në shtator, por gjithsesi do ta kemi parasysh.	

Lloji:	Total:	Statusi:
Koment	2	Pranohen
Koment	Përgjigje	
<ul style="list-style-type: none"> <li>Është një model për punën, transparencën dhe korrektesinë edhe për komunat e tjera.</li> <li>Deri më tani keni bërë një punë të shkëlqyer dhe uroj që edhe në të ardhmen të vazhdoni po njësoj.</li> </ul>	<b>Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës:</b> Falënderoj administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për realizimin e synimeve të përbashkëta dhe mirëqenien e qytetarëve. Kërkoi po ashtu të jenë si deri më tani, bashkëpunues por edhe mirëkuptues, të jenë ankues por edhe mirënjojës që së bashku po e bëjmë më të mirën për qytetarët tanë.	

Pas përfundimit të sesionit të kërkesave, pyetjeve, sugjerimeve dhe komenteve të këtij tubimi, nën kryetari i komunës, z. Arben Shala, e shpalli tubimin të myllur. Ai gjithashtu kujtoi të pranishmit se së shpejti do të mbahen dëgjimet buxhetore nëpër këshillat lokale.

Tubimi me publikun përfundoi në ora 15:30.





## Shtojca - 1

### Procesverbalit i bashkëngjitën edhe:

Faqe	Emërtimi
9	Paraqitja e pjesëmarrësve në formë tabelore
10	Ftesa dhe njoftimet përcjellëse në lidhje me Tubimin e Parë me Publikun
11	Njoftimi në gjuhën shqipe
12	Njoftimi në gjuhën serbe
13 - 14	Lista e pjesëmarrësve ne Tubimin e Parë me Publikun
15 - 16	Foto nga Tubimi i Parë me Publikun



## Paraqitura e pjesëmarrësve në formë tabelore



## Ftesa dhe njoftimet përcjellëse në lidhje me Tubimin e parë me Publikun

Ftesa dhe njoftimet përcjellëse në lidhje me Tubimin e Parë me Publikun janë publikuar edhe në kanalet zyrtare të komunës së Drenasit, gjithmonë brenda afateve ligjore.

Degëzat:

Ueb-faqe të Komunës:

<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2024/06/Tubimi-me-publikun-per-gjashtemujorin-e-pare-2024.pdf>

<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/takime-publike/>

Rrejti social - Facebook:

<https://www.facebook.com/share/fSFQv9kLr5HciQhi/?mibextid=WC7FNe>



# Njoftimi në gjuhën shqipe

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	10/1961 - 28		
Nj. Org.	Numër	Shtojci	Vjezë
01	030101-27781		



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 7 pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Komunale për Transparencë si dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci:

## ORGANIZON Tubim me publikun

**Të premten** më datën **28.06.2024** duke filluar në orën **14:00**.

Tubimi me publikun do të mbahet në **Sallën e Kuvendit** dhe ftohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara të Komunës, të marrin pjesë në këtë Tubim Publik duke ju përmبajtur terminit të caktuar më lart.

Në këtë Tubim me publikun përfaqësuesit e Komunës do të informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e Komunës për gjashtëmuajrin e parë të këtij viti, për të arriturat, vështirësitet dhe synimet, si dhe investimet kapitale, ndërsa pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe të japid propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmuajrin e parë dhe çështje tjera në interes të qytetarëve të Komunës.

Me respekt!



## Njoftimi në gjuhën serbe

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	10/06/ 2025		
Nj. Org.	Numir	Shtojca	Vizija
01 - 030101	27781		



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Opština Drenas-Municipality of Drenas  
Zyra e Kryetarit  
Kancelarija Predsednika Opštine



Imajući u vidu član 68. Poglavlje IX – Direktna demokratija i mehanizmi učešća građana, tačke 68.1, 68.2 i 68.3 koje se odnose na javno informisanje i konsultacije Zakona o lokalnoj samoupravi, članovi 21, 22, 23, 24, 25. Statut Opštine Glogovac, član 7 tačke 1, 2, 3, 4, 5 i 6 Opštinske uredbe o transparentnosti kao i član 17 Administrativnog uputstva za otvorenu upravu u opštinama, Predsednik Opštine Glogovac, Ramiz Lladrovci:

### O R G A N I Z U J E Okupljanje sa publikom

U petak datumom 28.06.2024 sa početkom u 14:00 časova.

Sastanak sa javnošću biće održan u Sali Skupštine i pozivaju se svi građani i zainteresovani subjekti opštine da učestvuju na ovom Javnom Skupu poštujući gore navedeni rok.

Predstavnici Opštine će na ovom sastanku sa javnošću informisati prisutne o aktivnostima Opštine za drugu polovicu ove godine, o dostignućima, poteškoćama i ciljevima, kao i o kapitalnim ulaganjima, a učesnici mogu postavljati pitanja i daje predloge predstavnicima izabranih opština u vezi sa realizacijom projekata planiranih za drugo polugodište i drugim pitanjima od interesa građana opštine.

S poštovanjem,

  
REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS  
MUNICIPALITY - KOMUNA GLLOGOC  
GLLOGOC MUNICIPALITY - KOMUNA GLLOGOC  
PREDSEDNIK OPŠTINE  
Ramiz Lladrovci





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Drenasit  
Opština Drenas-Municipality of Drenas  
Zyra për Komunikim me Publikun



**Lista e pjesëmarrësve në Tubimin e Parë me Publikun, datë: 28.06.2024**

Nr.	Emri	Mbiemri	Gjinia M F	Numri i telefonit	Nënshkrimi
1.	Osset Bytyqi	Fusti, e së Ep	M	044-470-085	<i>Osset Bytyqi</i>
2.	Rimor Morina	Gjloban	M	045-258-579	<i>Rimor Morina</i>
3.	HABIB GASHI	NEKOC	M	044-191-130	<i>Habib Gashi</i>
4.	Sami Bojanoffari	Jashnarekë	M.	064 201 296	<i>Sami Bojanoffari</i>
5.	DITON	ELEZI	M	044-411-411	<i>Diton Elezi</i>
6.	BUJAR	ELEZI	M	044-181-167	<i>Bujar Elezi</i>
7.	SUAT	ELEZI	M	044-752-038	<i>Suat Elezi</i>
8.	Edon	Thaqi	M	049547828	<i>Edon Thaqi</i>
9.	ILIR	MULAD	(M)	044 185-440	<i>Ilir Mulad</i>
10.	GENTRIT	GORRI	M		<i>Gentrit Gorri</i>
11.	MILMIN QOR	QORRI	M	049135090	<i>Milmin Qori</i>
12.	AGON	QORRI	M	0441091026	<i>Agon Qori</i>
13.	LSIM	SYJA	M	049-378-625	<i>Lsim Syja</i>
14.	Egzon	SYJA	M	044-640-658	<i>Egzon Syja</i>
15.	HABIB	MULSI	(M)	044353500	<i>Habib Muli</i>
16.	BEDIME	Nitho W	M.	048650227	<i>Bedime Nitho</i>
17.	XHEVDET	SITINHANI	M	044/287 844	<i>Xhevdet Sitinhan</i>
18.	FADIL	PRESIKU	M	0441164-136	<i>Fadil Presiku</i>
19.	AGRON	GASHANI	M	049 123 142	<i>Agron Gashani</i>
20.	ABDËR	BAZAJI	M.	044808333	<i>Abdër Bazaji</i>
21.	ISHAIL R.	HOTI	M	044 787 628	<i>Ishail R. Hoti</i>
22.	afshi Roza	Dorzet	M	044951306	<i>Afshi Roza Dorzet</i>
23.	Hetem	Ajazi	M	045892903	<i>Hetem Ajazi</i>
24.	KHORI	Ajazi	M.	044 613 075	<i>Khori Ajazi</i>
25.	XHAFER	DORZOOLUKI	M	044-264-231	<i>Xhafer Dorzoluki</i>
26.	LUZIM	JANOVA	M	049 171 083	<i>Luzim Janova</i>

\* Në këtë takim, përvetëksaj liste, do të bëhen fotografji dhe, me nënshkrinut tuaj, pajtohem që fotografjet dhe kjo listë të përdoren për komunikim zyrtar.



1.	Zekir	Kleina	M	044 296 399	<del>Lej</del>
28.	Neri	Berser	M	044 370 986	<del>Agnieszka</del>
29.	HADIS	TATIRATI	M	049-929-884	<del>Ilir</del>
30.	Fehmi	Berisha	M	044-384-535	<del>Officer</del>
31.	Andy	MZIU	M	049 221 880	<del>Fazilatun</del>
32.	KUSHTRIM	BAJRAKTARI	M	044 874-929	<del>Bernat</del>
33.	SHABAN	DOBRA	M	049-977-786	<del>Elisa</del>
34.	IBRAGIM	Horozova	M	044-175-597	<del>Sara</del>
35.	Afriim	Prokili	M	044-470-489	<del>Mari</del>
36.	Veli	Jasen	M	044 426 710	<del>Ilir</del>
37.	Minder	Perizha	M	049 678 337	<del>Sofia</del>
38.	Fidarie	Morina	F	044 1524-699	<del>Ilir</del>
39.	Edoné	Tahiraj	F		<del>Hilma</del>
40.	Alberto	lure	F	<del>044 132 094</del>	<del>Denis</del>
41.	Akbar	Hosan	M	048 561 215	<del>Sara</del>
42.	Anita	Avdulla Ku-Dvorani	F	044 777-437	<del>Melisa</del>
43.	Agnese	Kastrati - Bucalli	F	049-567-942	<del>Mari</del>
44.	ENDIT	Gjekolli	M	049-258-913	<del>Elma</del>
45.	PETRIT	GASHI	M	044-500-620	<del>Jugurta</del>
46.	Arlen	Slob	M	049-164-522	<del>Rox</del>
47.	KOSATEM	BAJRAKTARI	M	044-374-929	<del>Bernat</del>
48.	Enilda Dancer		F	049-977-957	<del>Sofia</del>
49.	Abulena Saliutu	Saliveti	F	048-663 665	<del>Ademir</del>
50.	Lumjije Kapi	Kapi	F	049- 778 444	<del>Ilir</del>
51.	Rejeti Shala	SINTANI	M	048-764-777	<del>Denis</del>
52.	Vlora Granci - Mjekicaj		F	049-929 900	<del>Mari</del>
53.	Lumtunje Rizm - Pekaj		F	049 977 802	<del>Mari</del>
54.	Attilinda Rukaj	Thakorli	F	044-993-841	<del>Drena Hilkka</del>
55.	Valdete Ramji		F	049-355-707	<del>Drena Ram</del>
56.	Zorja Tash		M	049/972-911	<del>Sofia</del>
57.	Loonora Shala	Taufiqe	F	049/523/096	<del>Sofia</del>
58.	Vlora Zogaku	Morina	F	044/424/095	<del>Xh</del>
59.	Zeljica Polovnjaka	Subotic	F	049 977 923	<del>Elma</del>
60.	INDJE KURT	BAJRAKTARI	F	049 832 882	<del>Gjergj</del>
61.	ANTIGONA	BUCOLLI	F	044-763-401	<del>Hilma</del>
62.	Mensur	Gllavci	M	044-502-087	<del>Denis</del>
63.	Ramit h.	Xyltar			<del>Ramit</del>

Ne këtë takom, përcjek kësaj liste, do t'ebeten fotografët që nuk janë nënshkrirë tuaj, pajtoheni që fotografët që kjo liste të përdoren përfshinë zyrat.



## Foto nga Tubimi i Parë me Publikun



